



Duke u mbështetur në nenin 41 dhe 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenit 42 dhe 49, të Statutit të Komunës dhe nenit 7 të Rregullores për Punë të Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, bënë këtë:

NJOFTIM

Njoftohen të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës së Klinës, që të marrin pjesë në seancën e VI-të, të punës për vitin 2013, që do të mbahet më 30.08.2013, në sallën e Kuvendit të Komunës së Klinës, duke filluar me punë në orën 10:00.

Kërkohet nga anëtarët e Kuvendit që të marrin pjesë në seancë, ndërsa në rast të mungesës eventuale, mungesa duhet të arsyetohet me shkrim para mbajtjes së mbledhjes.

Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në seancë, t'i referoheni dispozitës së nenit 39 të LVL-së.

Lidhur me këtë seancë propozohet ky:

REND I DITËS

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Preferencave të KPF-së,
4. Raporti ekonomik - financiar për zbatimin e planeve investuese të Komunës për gjashtëmujorin e parë të vitit 2013 (nga Kryetari i Komunës),
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit për menaxhimin financiar komunal për periudhën janar-qershor 2013 prej KPF-së (referon Drejtori Financave, Ekonomi dhe Zhvillim),
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim - vendimit për zhvendosjen e shtatores së "Nënë Terezës" në hapësirën më të përshtatshme në po të njëjtin shesh,
7. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të Debatit me Publikun, të dt.27.06.2013,
8. Të ndryshme.

01 Nr.06-3656 /13
Klinë, më 22.08 2013.



KRYESUESI,
Dr. Haxhi Ibishi